



UNOSEK/PR/9
E martë, 18 korrik 2006

Delegacionet e Prishtinës dhe Beogradit diskutojnë për zonën mbrojtëse përreth monumenteve fetare dhe kulturore në Kosovë

Vjenë – Delegacionet nga Prishtina dhe Beogradi sot në Vjenë kanë mbajtur raundin e dytë të bisedimeve të drejtpërdrejta për mbrojtjen e trashëgimisë fetare dhe kulturore në Kosovë. Bisedimet u mbajtën nën drejtimin e Emisarit Special të Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara për procesin e statusit të ardhshëm të Kosovës, z. Martti Ahtisaari, dhe u kryesuan nga kryesuesi i Sektorit për çështje politike të UNOSEK-ut, z. Petr Ivantsov.

Diskutimi i së martës u përqendrua në zonat mbrojtëse kryesisht në ato përreth manastireve dhe kishave ortodokse serbe në Kosovë. Z. Ivantsov sqaroi se diskutimet duhej të bazohen në propozimet e bëra nga ekspertët ndërkombëtarë pas vizitës që ata i kanë bërë Kosovës mes 12 dhe 18 qershorit. Delegacioni i përbërë nga ekspertët e UNOSEK-ut, UNESCO-os, UNMIK-ut dhe Këshillit të Evropës vizitoi 13 lokacione.

Z. Ivantsov tha: “Detyra ishte e natyrës teknike meqë ne u interesuam për parametra të ndryshëm të zonave konkrete”, duke shtuar se: “nuk është arritur asnjë marrëveshje në këtë fazë”.

Z. Ivantsov shtoi: “Ne i kemi propozimet e të dy palëve, i kemi rekomandimet tona dhe do të ulemi së bashku me ekspertët ndërkombëtarë për të parë nëse mund të arrijmë deri te një kompromis i arsyeshëm”. Ai sqaroi se tani qëllimi i UNOSEK-ut është që t’i vazhdojë diskutimet në një të ardhshme të afërt. Ai gjithashtu ftoi palët që të japin propozimet e tyre lidhur me një mekanizëm për monitorim dhe zbatim të marrëveshjes në fushën e trashëgimisë kulturore dhe fetare.

Raundi tjetër i bisedimeve të drejtpërdrejta lidhur me decentralizimin mbahet nesër, më 19 korrik 2006.